



Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universiteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar rre. n.	10.02.2022
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-20

KOMUNA E OBILIQIT-OPSTINA OBILIC
Zyra e Administratës Përgjithshme
IPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE



10.02.2022

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"UKSHIN HOTI" PRIZREN**

**KOMUNA E OBILIQIT
OBILIC MUNICIPALITY**

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" PRIZREN

DHE

KOMUNËS SË OBILIQIT

Kjo kontratë është e lidhur , me datë 10.02. 2022,

Baza Juridike :

1. LIGJI NR. 06/L - 114 PËR ZYRTARËT PUBLIKËNeni 34,parag.12.
2. RREGULLORE (QRK) NR. 16/2020 PËR PRANIMIN DHE KARRIERËN NË SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS Neni 18 parag.2.3.

Neni 1

Marrëveshja e Bashkëpunimit (në tekstin e mëtejme Marrëveshje) lidhet mes Komunës së Obiliqit, e përfaqësuar nga Kryetari z.Xhafer Gashidhe Universitetit "Ukshin HOTI" i Prizrenit, përfaqësuar nga Ud Rektori Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj.

Neni 2

Qëllimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit është të përcaktojë kushtet e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve për interesin reciprok.

Neni 3

Komuna e Obiliqit dhe Universiteti "Ukshin HOTI" i Prizrenit pajtohen që Universiteti të ofroj një listë të stafit akademik dhe profesional si dhe profesionin e tyre me qëllim që Komuna të evidentojë ekspertin adekuat i cili do të jetë pjesë e Komisionit për pranim në Shërbimin Civil.

Neni 4

Komuna e Obiliqit dhe Universiteti "Ukshin HOTI" të Prizrenit pajtohen që në bashkëpunim të caktojnë ekspertin i cili do të jetë pjesë e Komisionit për pranim në Shërbimin Civil, vlerësim-intervistim të kandidatëve.

Neni 6

Komuna e Obiliqit dhe Universitetit "Ukshin HOTI" i Prizrenit pajtohen që eksperti/professori i caktuar do të ketë pagesë fikse, sipas legjislacionit në fuqi, që paguhet për secilën procedurë të konkurrimit për ekspertin e angazhuar.

Neni 8

Komuna e Obiliqit dhe Universiteti "Ukshin HOTI" pajtohen që të bashkëpunojnë gjatë procesit të rekrutimit, përgatitjen e testit me shkrim, pyetje profesionale dhe intervistimin me gojë.

Neni 9

Marrëveshja ka afat vlefshmërie për periudhë 3 (tre) vjeçare të bashkëpunimit me mundësi vazhdimi, plotësim ndryshimi me pajtimin e dy palëve.



Neni 14

Marrëveshja e bashkëpunimit është e nënshkruar në 4 (katër) kopje të mjaftueshme për secilën palë. Kjo marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Përfaqësuar nga:

Ud Rektori:

Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj



Shkurt, 2022

Kryetari i Komunes:

z. Xhafer Gashi

